




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 414/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković -Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Ejona” shpk- Peje, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Rregullimi dhe montimi i pompave me ujë në ndërtesat kolektive” me nr prok: 616-19-1481-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën 29 gusht 2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Ejona” shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi dhe montimi i pompave me ujë në ndërtesat kolektive” me nr prok: 616-19-1481-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për anulim lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Rregullimi dhe montimi i pompave me ujë në ndërtesat kolektive” me nr prok: 616-19-1481-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Prishtinë, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Ejona” shpk aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 22.03.2019

Data e planifikuar për hapjen e ofertave: 24.04.2019

Njoftimi i vendimit nga AK me datë 27.06.2019 është bërë njoftimi për anulim të Aktivitetit të Prokurimit.

Me datë 01.07.2019 është parashtruar kërkesa për rishqyrtim, ndërsa me datë 03.07.2019 AK përmes vendimit e refuzon ankesë të pabazuar dhe mbetet në fuqi njoftimi i vendimit të AK-së.

Me datën: 08.07.2019 OE. "Ejona" Sh.p.k.-Pejë ka parashtruar ankese për aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi dhe montimi i pompave për furnizim me ujë në ndërtesat kolektive" me nr. prokurimi 616-19-1481-5-2-1 i realizuar nga Komuna e Prishtinës (KKP).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 17.07.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 29.07.2019, ka konstatuar se Sqarim Hyrës:

Autoriteti Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, dhe e ka refuzuar ankesën e OE ankues si të pa bazuar, dhe e ka lënë në fuqi vendimin për anulim të aktivitet të prokurimit.

I pa kënaqur me përgjigjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim, OE "Ejona" - Pejë parashtron ankese në OSHP për shkelje të dispozitave të LPP-së të lartë cekura në ankesë.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore

Duke i referuar raporti të vlerësimit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit Eksperti Shqyrtues konsideron se komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar ofertat në përputhje me të drejtat dhe obligimet që ka si

komisioni i vlerësimit për arsye se komisioni vlerësues pranë AK-së ka për obligim të vlerësoj përgjegjshmërinë apo papërgjegjshmërinë e ofertave të OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit lidhur me kërkesat e parashtruar në njoftim për kontratë, respektivisht në dosje të tenderit, pra komisioni duhet marrë për bazë kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin për caktuar për vlerësim, e që në rastin konkret kriter vlerësimi ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët me poentim pasi që është sasia e pozicioneve ka qenë një (1).

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar arsye e eliminimit ka qenë së OE "Ejona" ka ofruar çmime mbi çmimet e tregut konkretisht në pozicionet 11,29,30,31,32,33,42,43,51 dhe 53, por është e pa qartë se çka ka marrë për bazë komisioni i vlerësimit dhe zyrtari i lartë i prokurimit kur ka konsideruar se çmimet janë mbi çmimet e tregut nuk ju kanë referuar ndonjë çmimi referent.

OE ankues ka dorëzuar një listë me çmimet e pompave nga prodhues evropian dhe çmim i secilit pozicion të theksuar rezulton të jenë më të larta apo përafërsisht të barabartë me çmimet e ofertës.

Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk mund të bëjë krahasime të çmimeve me pozicioneve të OE-ve, pasi që secilit pozicion i është dhënë pesha dhe vlerësimi i çmimit për pozicion duhet bërë mbi bazën e peshës së dhënë, që do të thotë se nuk mund të bëjmë krahasime të çmimeve me OE pjesëmarrës.

Sipas dispozitave të UOPP-së shprehimisht thuhet:

Neni 28.12 Në rast të kriterit tenderi me çmimin më të ulët nuk lejohet konvertimi i çmimeve në pike dhe të peshohen piket. Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet përfundimisht mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto rast Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj frekuencën dhe rëndësinë e secilit artikull ose frekuencën dhe rëndësinë e secilës kategori të shërbimeve dhe do të peshoj çmimin në bazë të rëndësisë. Këto pesha do të përdoren vetëm për qëllimin e artikullimit të rëndësisë së secilit shërbim apo artikull, dhe për të qenë në gjendje për të zgjedhur ofertën me çmimin më të ulët.

Neni 28.13 Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuar bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen piket duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.

Neni 28.14 Funkcioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave.

Sipas nenit 28.15 Rreptësisht ndalohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pike, mandej të peshohen piket pasi që në këtë mënyrë piket më të larta të poentuar jo domosdoshmërisht do të rezultojnë në çmimin më të ulët.

Autoritet kontraktues në përputhje me nenin 28.16. të UOPP në Dosjen e Tenderit ka përcaktuar peshën (rëndësinë) e çmimeve të kategorive specifike, duke ju dhënë peshë secilit pozicion. Eksperti shqyrtues Vlerëson se AK aktivitetin e prokurimit nuk ka anuluar në përputhje me dispozitat e LPP-së

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka respektua nenet si në vijim:

- Nenin 59 vlerësimi dhe ekzaminimi i ofertave
- Nenin 60 të LPP-së
- Nenin 62 të LPP-së .
- Nenin 72 i Informatat shtese

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues vlerëson se ankesa e OE ankues "Ejona" është e bazuar dhe i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të rivlerësojë aktivitetin e prokurimit.

Operatori ekonomik nuk është deklaruar për mendimin e ekspertit shqyrtues të dhënë në ekspertizë.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 02.08.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 29.08.2018, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues të prokurimit konstaton se duke i referuar raportin të vlerësimit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar ofertat në përputhje me të drejtat dhe obligimet që ka si komision i vlerësimit për arsye se komisioni vlerësues pranë AK-së ka për obligim të vlerësojë përgjegjshmërinë apo papërgjegjshmërinë e ofertave të OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit lidhur me kërkesat e parashtruar në njoftim për kontratë,

respektivisht ne dosje te tenderit, pra komisioni duhet marre për baze kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin për caktuar për vlerësim, e që në rastin konkret kriter vlerësimi ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim me te ulet me poentim pasi që sasia e pozicioneve ka qenë një (1).

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar arsye e eliminimit ka qenë së OE "Ejona" ka ofruar çmime mbi çmimet e tregut konkretisht në pozicionet 11,29,30,31,32,33,42,43,51 dhe 53, por është e pa qartë se çka ka marrë për bazë komisioni i vlerësimit dhe zyrtari i lartë i prokurimit kur ka konsideruar se çmimet janë mbi çmimet e tregut nuk ju kanë referuar ndonjë çmimi referent .

OE ankues ka dorëzuar një liste me çmimet e pompave nga prodhues evropian dhe çmim i secilit pozicion të theksuar rezulton të jenë më të larta apo përafërsisht i barabartë çmimet ofertës.

Ne rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk mund të bëjë krahasime të çmimeve me pozicioneve të OE-ve , pasi që secilit pozicion i është dhe pesha dhe vlerësimi i çmim për pozicion duhet bërë mbi bazën e peshës se dhenë, që do të thotë se nuk mund të bëjmë krahasime të çmimeve me OE pjesëmarrës.

Sipas dispozitave të UOPP-së shprehimisht thuhet:

Neni 28.12 në rast të kriterit tenderi me çmimin më të ulët nuk lejohet konvertimi i çmimeve në pike dhe të peshohen piket. Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet përfundimisht mund të peshohen në baze të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. . Në këto rast Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj frekuencën dhe rëndësinë e secilit artikull ose frekuencën dhe rëndësinë e secilës kategori të shërbimeve dhe do të peshoj çmimin në bazë të rëndësisë. Këto pesha do të përdoren vetëm për qëllimin e artikullimit të rëndësisë së secilit shërbim apo artikull, dhe për të qenë në gjendje për të zgjedhur ofertën me çmimin më të ulët.

Neni 28.13 Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuar bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen piket duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.

Neni 28.14 Funkcioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në baze të çmimit të ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjatë procesit të hapjes së ofertave.

Sipas nenit 28.15 Rreptësisht ndalohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pike, mandej të peshohen piket pasi që në këtë mënyrë piket më të larta të poentuar jo domosdoshmërisht do të rezultojnë në çmimin më të ulët.

Autoritet kontraktues ne përputhje me nenin 28.16. të UOPP në Dosjen e Tenderit ka përcaktuar peshën (rëndësinë) e çmimeve të kategorive specifike, duke ju dhënë peshë secilit pozicion. Eksperti shqyrtues Vlerëson se AK aktivitetin e prokurimit nuk ka anuluar ne përputhje me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59, 62 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .


Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 OE - "Ejona"shpk

1x1 AK- "KK Prishtine"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.